



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 6 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim për caktimin e datës së paraqitjes së parë dhe çështjeve të lidhura me të**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hashim Thaçit**  
David Huper

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në bazë të neneve 20 dhe 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 8(3)(a), 87(6), 92(1) dhe 96 të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon vendimin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 prill 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialin provues, në mbështetje të akuzave si dhe një përmbledhje të detajuar që paraqiste lidhjen e secilës pikë të materialit provues me secilën akuzë.<sup>2</sup>

2. Më 24 korrik 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar, duke vepruar sipas urdhrit<sup>3</sup>, paraqiti për konfirmim një aktakuzë të rishikuar (“Aktakuza e Rishikuar”)<sup>4</sup>.

3. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar (“Vendimi i konfirmimit”)<sup>5</sup>, lëshoi një fletarrestim për Hashim Thaçin (“z. Thaçi” apo të “akuzuarin”)<sup>6</sup> dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”)<sup>7</sup>.

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-06, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës për konfirmim*, 24 prill 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-06, F00010, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Prokurorin e Specializuar*, në përputhje me rregullën 86(4) të Rregullores, 2 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-06, F00011, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i aktakuzës së rishikuar për konfirmim*, 24 korrik 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit* (“Vendimi i konfirmimit”), 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-06, F00027/A01, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Fletarrestimi për Hashim Thaçin*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-06, F00027/A02, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për transferimin në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

4. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e konfirmuar,<sup>8</sup> me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>9</sup>
5. Më 5 nëntor 2020, z. Thaçi u arrestua<sup>10</sup> dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.<sup>11</sup>
6. Më 5 nëntor 2020, Administratorja caktoi z. David Huper si mbrojtës të zotit Thaçi.<sup>12</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

### A. PARAQITJA E PARË

7. Sipas nenit 39 (4) të Ligjit, në zbatim të urdhërarrestit ose fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, personi kundër të cilit është konfirmuar aktakuza merret në ndalim, informohet menjëherë për akuzat kundër tij ose saj dhe transferohet në Dhomat e Specializuara.
8. Në bazë të rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores, i akuzuari nxirret para Gjykatësit të Procedurës Paraprake pa vonesë të papërligjur për paraqitjen tij apo të saj të parë.
9. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat, duke përfshirë edhe seancën e paraqitjes së parë të të akuzuarit, janë publike, përveçse kur Gjykatësi i Procedurës Paraprake vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-06, F00034/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit të aktakuzës së konfirmuar dhe kërkesave të lidhura me të*, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Më 4 nëntor 2020, u paraqit një aktakuzë e korrigjuar dhe e konfirmuar, në të cilën ishin korrigjuar disa gabime shtypi, F00045/A01, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>9</sup> Vendimi i konfirmimit, para. 521(c) dhe (d).

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-06, F00051, Administratorja, *Njoftim i arrestimit të Hashim Thaçit*, sipas rregullës 55(4), rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>11</sup> KSC-BC-2020-06, F00053, Administratorja, *Njoftimi i pranimit të Hashim Thaçit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi emërimin e mbrojtësit ("Njoftimi i transferimit")*, 5 nëntor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

<sup>12</sup> Njoftimi i transferimit, paragrafi 6.

## B. GJUHËT E PUNËS

10. Në bazë të nenit 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze dhe gjatë çdo procedure paneli mund të vendosë për gjuhën e punës gjatë procedurë, sipas nevojës dhe duke i respektuar në plotësi të drejtat e të akuzuarve.

11. Në përputhje me rregullën 8(3)(a) të Rregullores, duke mbajtur parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

## C. KONFERENCAT MBI ECURINË E ÇËSHTJES

12. Në përputhje me rregullën 96(1) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbledh një konferencë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore sa më shpejt që të jetë e mundshme pas paraqitjes së parë të të akuzuarit për: (i) organizimin e shkëmbimeve midis palëve dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësit të viktimave për të mundësuar përgatitje të shpejtë për gjykimin; (ii) ndërmarrjen e hapave që mundësojnë çdo përgatitje të nevojshme prej palëve në mënyrë të zellshme dhe në kohë; dhe (iii) rishikimin e ecurisë së çështjes gjyqësore që palëve, e kur është e zbatueshme mbrojtësit të viktimave, t'u jepet mundësia e ngritjes së problemeve në lidhje me çështjen gjyqësore.

13. Në përputhje me rregullën 96(2) të Rregullores, konferenca për ecurinë e çështjes gjyqësore mund të mbahet: (i) në praninë e të akuzuarit dhe me pjesëmarrjen e mbrojtësit të tij apo të saj nëpërmjet videokonferencës; (ii) në praninë e mbrojtësit dhe me pjesëmarrjen e të akuzuarit nëpërmjet videokonferencës; ose (iii) në mungesë të të akuzuarit me praninë e mbrojtësit ose me pjesëmarrjen e mbrojtësit përmes videokonferencës.

### III. DISKUTIM

#### A. PARAQITJA E PARË

14. Duke marrë parasysh se arrestimi i z. Thaçi dhe transferimi i tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara u kryen më 5 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e gjykon të përshtatshme të caktojë një seancë për paraqitjen e parë të të akuzuarit sa më shpejt që të jetë e realizueshme, duke mbajtur parasysh kufizimet prej covid-19, me qëllim që të respektohen të drejtat e tij të parapara në Ligj. Për vendosjen e datës së paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake merr gjithashtu parasysh edhe kërkesën e mbrojtësit të z. Thaçi që ajo të mbahet përpara ditës së martë, 10 nëntor 2020<sup>13</sup>.

15. Gjithashtu duke marrë shënim se seancat mund të bëhen publike edhe jashtë sallës së gjyqit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon bërjen e fotografive në fillim të seancës së paraqitjes së parë.

#### B. GJUHËT E PUNËS

16. Duke pasur parasysh arrestimin dhe transferimin e z. Thaçi dhe në përputhje me të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit, është e domosdoshme të vendoset gjuha e punës e këtij procesi, në mënyrë që të sigurohet zhvillimi i drejtë, efikas dhe i shpejtë i tij. Për këtë qëllim, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron palët që të paraqesin vërejtjet e tyre në formë verbale lidhur me gjuhën e punës së procesit gjatë paraqitjes së parë.

17. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, deri më tani, gjuha e punës e procesit ka qënë gjuha angleze, sepse të gjitha parashtrimet e protokolluara të paraqitura nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Administratorja si dhe të gjitha vendimet dhe urdhërat e Gjykatësit të Procedurës Paraprake janë lëshuar në gjuhën angleze.

---

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00056/A01, Administratorja, *Shtojca 1 e Njoftimit mbi marrjen e kërkesës nga mbrojtësi i Hashim Thaçit*, 5 nëntor 2020, konfidenciale

Rrjedhimisht, pasi të ketë marë vërejtjet e palëve, gjykatësi i procedurës paraprake do të vendosë nëse ka arsye bindëse për të hequr dorë nga përdorimi i gjuhës angleze si gjuhë pune.

18. Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se vendimi mbi gjuhën e punës së procedurës nuk do të ketë ndikim mbi gjuhën dhe/apo përkthimin e provave dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm në dobi të të akuzuarit.<sup>14</sup>

#### C. DATA E KONFERENCËS PËR ECURINË E ÇËSHTJES

19. Gjykatësi i Procedurës Paraprake fton palët që të paraqesin parashtrimet e tyre gjatë paraqitjes së parë, duke deklaruar disponueshmërinë e tyre për të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes më, apo pas datës 18 nëntor 2020. Mbrojtja ftohet të bëjë të qartë në parashtrimin e vet nëse mbrojtësi dhe/apo z. Thaçi është i gatshëm të marrë pjesë në konferencën mbi ecurinë e çështjes duke qënë fizikisht i pranishëm apo përmes videokonferencës, siç përcakton rregulla 96(2) e Rregullores.

#### IV. VENDIM

20. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të mbajë seancë për paraqitjen e parë të z. Thaçi, **të hënën, më 9 nëntor 2000, në orën 15:00;**
- b) **AUTORIZON** Administratoren të organizojë në fillim të seancës së paraqitjes së parë bërjen e fotografive për një minutë e gjysmë.
- c) **URDHËRON** palët që në seancën e paraqitjes së parë të paraqesin parashtrimet e tyre verbale lidhur me gjuhën e punës që duhet të përdoret në këtë proces; dhe

---

<sup>14</sup> Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores

- d) **FTON** palët që në seancën e paraqitjes së parë të paraqesin parashtrimet e tyre verbale, siç përcaktohet në paragrafin 19 më sipër, lidhur me disponueshmërinë e tyre për një konferencë mbi ecurinë e çështjes, të mërkurën, 18 nëntor 2020, apo pas kësaj date.

\_\_\_\_\_  
/nënshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatës i Procedurës Paraprake**

E premte, 6 nëntor 2020

Hagë, Holandë.